



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3364/11 prot

Datë 29.01.2026

V E N D I M
Nr. 167/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 57/2026, datë 13.01.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Almedical” SHPK, me NUIS KK21511002I, me adresë Rruga Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Gamma” SHPK, me NUIS K31510153H, me adresë Njesia Administrative nr.8, Rruga Dervish Hekali, Ndertesa nr.8, Tirane.

Operatori Ekonomik “Krijon” SHPK, me NUIS K12023001A, me adresë Rruga e Elbasanit, Nr. 57, Çollak, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar;
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë
13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin
dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.01.20265, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 57/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” SHPK për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit për skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Gamma” SHPK nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” SHPK nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK.
5. Autoriteti kontraktor të bëjë rivlerësim të procedurës së prokurimit, në zbatim të konstatimeve të KPP-së në këtë vendim si dhe referuar vendimit të KSHA-së nr.144/2025 sa i përket pretendimeve të shoqërisë “Gamma” SHPK për ofertën e shoqërisë “Krijon” SHPK.
6. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të KSHA -së, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Almedical” SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Gamma” SHPK.

9. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “Krijon” SHPK.
10. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën 425/23 prot., datë 20.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3364/8 prot., datë 23.01.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin nr.57/206, datë 13.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti I “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, bashkëngjitur dokumenti mbi rivlerësimin e procedurës së prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën 425/23 prot., datë 20.01.2026, protokolluar me tonën nr. 3364/8 prot., datë 23.01.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin nr.57/206, datë 13.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti I “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, bashkëngjitur dokumenti mbi rivlerësimin e procedurës së prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit nr.57/2026, datë 13.01.2026. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.57/2026, datë 13.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 63098-09-30-2025, me objekt: “Loti 1 “Blerje standarde”, Për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinartisë (ISUV)”, me fond limit 8.958.264 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

